



Oda e Stomatologëve të Kosovës

Stomatološka Komora Kosova • Dental Chamber of Kosovo

DOKUMENT MBI

STRATEGJINË E ZHVILLIMIT TË STOMATOLOGJISË

Prishtinë, prill 2022

PARATHËNIE

Krijimin e këtij dokumenti e kemi parë si shumë të domosdoshëm, si vazhdimësi e diskutimeve të nivelit profesional në forume të ndryshme, pastaj paralajmërimeve nga Ministria e Shëndetësisë për transformimin e sistemit shëndetësor dhe nga ana tjetër mospërfshirja e Odës së Stomatologëve të Kosovës, apo bile të ndonjë profesionisti të vetëm nga sektori i stomatologjisë në grupin punues për ndryshim dhe plotësim të ligjit për shëndetësi.

Prandaj mendojmë se nuk mundet vetëm një grup personash të jetë garant i realizimit të transformimit të sektorit të stomatologjisë, pa qenë e përfshirë drejtpërdrejtë edhe OSK-ja që i ka kapacitetet e saja për ta çuar këtë proces në rrugën e duhur.

Pas diskutimeve të nivelit profesional dhe publik si dhe të organizimit të tryezës me temë “Gjendja në sektorin e stomatologjisë: e sotmja dhe e ardhmja”, Oda e Stomatologëve të Kosovës ka hartuar këtë dokument të rëndësishëm me sygjerimet e reja, se si e shohin të ardhmen e zhvillimit të shërbimit shëndetësor stomatologjik në Republikën e Kosovës profesionistët e saj, duke pasur çdoherë parasysh interesat e qytetarëve dhe komunitetit tonë.

Në këtë dokument është analizuar në mënyrë të përmbledhur e të qartë situata aktuale në sektorin e stomatologjisë në Republikën e Kosovës dhe është shprehur vizioni ynë për reformimin e tij, të bazuar në modelet e përvojat e suksesshme bashkëkohore. Zbatimi i këtyre modeleve kërkon ndryshimin e bazës ligjore aktuale të organizimit, financimit dhe menaxhimit për të bërë të mundur realizimin e objektivit tonë final: “Sigurimin dhe përmirësimi i vazhdueshëm i kujdesit stomatologjik për popullatën tonë”. Shpreh bindjen që zbatimi i suksesshëm i kësaj strategjie zhvillimore do të kishte përmirësuar dukshëm organizimin dhe funksionimin e shërbimit shëndetësor stomatologjik në vendin tonë, duke e transformuar atë në një sistem bashkëkohor të krahasueshëm me atë të vendeve të zhvilluara rajonale e më gjërë.

Suksesi i realizimit të kësaj strategjije zhvillimore kërkon domosdoshmerisht jo vetëm përkushtimin e Odës së Stomatologëve, gjegjësisht profesionistëve të sistemit shëndetësor, por edhe mirëkuptimin, mbështetjen dhe konsensusin e gjerë, vullnetin e plotë politik, vazhdimësinë etj.

Prof.Dr. Blerim Kamberi

Kryetar i Odës së Stomatologëve të Kosovës

A. HYRJE

1. Oda e Stomatologëve të Kosovës

Oda e Stomatologëve të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Oda) është themeluar me Ligjin për Odat e Profesionistëve Shëndetësor më 30 maj 2013, si organizatë e pavarur profesionale e stomatologëve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre profesionale në Republikën e Kosovës. Kuvendi i I (parë) i Odës është mbajtur më 25 nëntor 2014.

Oda përfaqëson anëtarësinë e saj brenda dhe jashtë vendit.

Në kuadër të kompetencave të saj, Oda kryen një sërë detyrash të përcaktuara me Ligjin për Shëndetësi nr. 04/L-125 Ligjin për Odat e Profesionistëve Shëndetësor Nr. 04/L-150 dhe Statutit të Odës, i miratuar nga ministri më 22 tetor 2015 dhe akteve tjera normative.

1.1 Anëtarësia e Odës së Stomatologëve të Kosovës

Të gjithë stomatologët, që kryejnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Kosovës janë të detyruar të anëtarësohen në Odë.

OSK numron gjithsej **2079** anëtarë.

Shpërndarja e anëtarësisë së Odës sipas vendbanimit është si më poshtë:

	Vendbanimi	Nr.
1.	Prishtinë	757
2.	Prizren	199
3.	Pejë	151
4.	Gjilan	147
5.	Gjakovë	138
6.	Ferizaj	130
7.	Mitrovicë	67
8.	Suharekë	54
9.	Fushë Kosovë	40
10.	Istog	38
11.	Vushtrri	36
12.	Podujevë	32
13.	Rahovec	31
14.	Lipjan	29

15.	Skenderaj	27
16.	Shtime	26
17.	Drenas	26
18.	Deçan	23
19.	Viti	21
20.	Klinë	20
21.	Kaçanik	17
22.	Malishevë	16
23.	Kamenicë	15
24.	Dragash	12
25.	Obiliq	7
26.	Junik	3
27.	Graçanicë	1
28.	Novobërdë	1
29.	Hani i Elezit	1
30.	Shtërpc	1

B. VËSHTRIM I GJENDJES AKTUALE ME STRATEGJI TË ZHVILLIMIT

2. Edukimi I anëtarëve të Odës

2.1 Edukimi themelor universitar

Në Kosovë, në sistemin publik, studimet universitare për stomatologji kryhen përmes programit gjashtëvjeçar në Fakultetin e Mjekësisë-Dega e Stomatologjisë, dhe në sistemin privat në tre kolegje kryhen studimet në drejtimin e stomatologjisë përmes programit pesë, gjegjësisht gjashtëvjeçar (Kolegji Rezonanca, UBT dhe AAB). Me dispozitat ligjore titulli profesional i cili fitohet pas përfundimit të studimeve në drejtimin e stomatologjisë në Kosovë, është "Doktor i Stomatologjisë".

Përgatitja kuantitative dhe kualitative e profesionistëve ka mjaft probleme, që shpesh i kanë zhgënjyer të rinjtë por edhe familjet e tyre. Tregut shpesh i ofrohen stomatolog të përgjithëm apo edhe specialistë që nuk kanë pasur rastin të marrin edukim të mjaftueshëm.

Liberalizimi i Institucioneve të arsimit të lartë për drejtimin e stomatologjisë dhe numri i madh i studentëve që pranohen në vitin e parë në drejtimin e stomatologjisë

pa ndonjë planifikim dhe strategji në nivel vendi (sistemi public/privat) po krijon një kontingjent jociësor të profesionistëve dhe numër më të madh të tyre se nevojat e tregut për ta.

2.1.1 Strategjia e zhvillimit

Nisur nga situata aktuale, mundësia e studimit për drejtimin e stomatologjisë në këto institucione, gjegjësisht kuotat e regjistrimit në institucionet publike dhe private në nivel të Republikës së Kosovës duhet kufizuar.

Kuota e regjistrimit të studentëve të harmonizohet me nevojat ekzistuese të popullsisë së përgjithshme në Kosovë sipas standardeve të OBSH-së.

Fondet për studimet universitare në drejtimin e stomatologjisë të rriten sepse tashmë janë të pamjaftueshme për shkak të kushteve, përmbajtjes dhe mënyrës së kryerjes së studimit.

Me qëllim të eliminimit të diskrepancës dhe jo proporcionalitetin në mes prodhimit të profesionistëve të rinj të stomatologjisë dhe nevojave të tregut të punës për këtë kategori duhet të përfshihen bashkarisht institucionet relevante (MSH, OSK, fakulteti i mjekësisë, rektorati dhe MASHT).

2.2 Edukimi specialistik

Numri i specialistëve sipas llojit të specializimit në vendin tonë është si më poshtë:

Protetika Stomatologjike	143
Pedodoncia dhe Stomatologjia Preventive	125
Ortodoncia	110
Kirurgjia Orale	97
Sëmundjet e dhëmbit me Endodoncion	80
Parodontologjia dhe Mjekësia Orale	74
Kirurgjia Maksillofaciale	40
Stomatologjia e Përgjithshme	4
Gjithsej	673

Problemi më i mprehtë nga viti në vit mbetet problemi i numrit të madh të specialistëve, mungesës së hapësirës, pajisjeve dhe materialeve si dhe numrit të vogël të mentorëve klinik për disa degë specialistike.

Aktualisht, numri i specialistëve është enormë i lartë **382 + 28 kirurgji maksillofaciale = 410**.

Numri i specialistëve sipas lëmive është si më poshtë:

Lloji i specializimit	Nr. i specialistëve
Ortodonci	99
Kirurgji Orale	93
Parodontologji dhe Mjekësisë Orale	63
Protetika Stomatologjike	61
Sëmundje e dhëmbit me Endodoncion	41
Pedodoncia dhe Stomatologjia Preventive	19
Kirurgjia maksillofaciale	28
Gjithsej	410

Mentorët klinik marrin një kompensim simbolik për punën, pavarësisht numrit të madh të specialistëve.

Kapacitetet ekzistuese të QKSUK-së ku kryhet edukimi specialistik janë **91** vende pune të shfrytëzuara ku kryhen trajnime specialistike, por në të njëjtën kohë për të njëjtat pozicione janë **88 specialistë**, si dhe **250 student** të Degës së Stomatologjisë që realizojnë mësimin praktik klinik.

Vjetërimi dhe mungesa e pajisjeve, është një faktor rëndues në organizimin dhe cilësinë e zhvillimit të specializimit në klinikat e QKSUK.

Nuk ofrohen fare programi praktik nga ortodoncia fikse dhe nga implantologjia, sepse këto shërbime nuk ofrohen në QKSUK.

Fonde shtesë për material dhe pajisje për specialistët dhe studentët (kryesisht) nuk ka, pra, specialistët dhe studentët shfrytëzojnë materialin dhe paisjet të destinuara për punën e përditshme për specialistët e QKSUK-së.

Prandaj këto mangësi evidente kushtëzojnë një ngecje të madhe në realizimin e programit të edukimit specialistik në lëmitë stomatologjike.

2.2.1 Strategjia e zhvillimit

Zbatimi i Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësor dhe bartja e kompetencës dhe përgjegjësisë në fushën e edukimit specialistik nga Ministria e Shëndetësisë tek Oda.

Definimi i rolit të Ministrisë së Shëndetësisë. Përgjegjësia në planifikim të nevojave reale për llojin e specializimeve, aprovimin e kërkesave sipas nevojave për specializime nga institucionet shëndetësore, hapjen e konkurseve si dhe përzgjedhjen e kandidatëve.

Definimi i rolit të Odës. Përgjegjësia në organizimin, zhvillimin e programeve specialistike, organizimin e provimit specialistik si dhe verifikimin e ligjshmërisë së procesit të specializimit.

Planifikim i numrit të specializantëve sipas degëve specialistike (të pranohen deri në 10 specializantë në vit sipas degëve specialistike), të cilët do të fillonin specializimin në të njëjtën kohë (1 tetor i vitit aktual) dhe kështu të ketë tre gjenerata të vitit të parë, të dytë dhe të tretë me deri në 10 specializantë në vit.

2.3 Edukimi i Vazhdueshëm Profesional

Sipas aktit të përgjithshëm të Odës – Rregullorja mbi Edukimin e Vazhdueshëm Profesional, Oda, përcakton planin dhe programin vjetor për aftësim profesional nga propozimet e veta dhe nga propozimet e Institucioneve të niveli terciar (QKSUK) dhe fakultetit të Mjekësisë, institucioneve të kujdesit dytësor stomatologjik; shoqatat e ndryshme profesionale, institucioneve private të arsimit të lartë, si dhe komunitetit biznesor.

EVP është përcjellur me mjaftë vështërsi, shpërthimi i pandemisë, ndalimi i tubimeve, por edhe brengosëse ka qenë joserioziteti i niveli terciar, të cilët nuk kanë dërguar ndonjë program të aftësimit profesional dhe nuk kanë patur ndonjë aktivitet të mbajtur për edukim të vazhdueshëm profesional.

Konferencat e zhvillimit profesional të organizuara nga Oda kanë arritur sadopak t'i siguroj anëtarësisë së vet njohuritë më të reja në fushën e stomatologjisë nëpërmjet ekspertëve të huaj dhe vendor. Poashtu edhe organizimi i kurseve cilësore nga komuniteti biznesor ka arritur të rrisë frekuentimin dhe interesimin e anëtarësisë.

2.3.1 Strategjia e zhvillimit

Vazhdimi i organizimit të konferencave vjetore dhe ciklit të ligjëratave profesionale në QKMF rajonale nga ana e OSK-së.

Organizimi i aktiviteteve profesionale të lëmive të ndryshme nga QKSUK, QKMF, shoqatat e ndryshme profesionale, institucioneve private të arsimit të lartë, si dhe komunitetit biznesor me tema të reja dhe ligjërues që zgjojnë interesimin e kolegëve, si dhe një numër të madh kursesh pune me pjesëmarrje aktive të pjesëmarrësve, të cilat tërheqin shumë vëmendjen.

Të vazhdohet me bashkëpunimin e shkëlqyer rajonal me kolegë nga vendet, si Kroacia, Bosnja e Hercegovina,, Maqedonia Veriore dhe Shqipëria, s dhe të zgjerohet bashkëpunimi edhe në vende të tjera.

Me qëllim të informimit të menjëhershëm të anëtarësimit së Odës, të fillohet me mbajtjen e rregullt të “Ditëve të Hapura të Odës” dhe “Tryezave të Rrumbullakëta” për tema të ndryshme profesionale në të gjitha qendrat rajonale të QKMF-së, si dhe t’ju mundëset që çdo anëtar i Odës të marrë pjesë aktive në bisedë për të shprehur mendimet, vëzhgimet, përvojat dhe komentet e tyre për punën e Odës dhe institucioneve kompetente.

Zhvillimi i modulit elektronik për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional me të cilin arrijmë akreditim më të shpejtë dhe më të thjeshtë për aktivitetet e zhvillimit profesional, dhe qasja në identifikimin e secilit pjesëmarrës në aktivitetin e organizuar si dhe secili anëtar i Odës do të mund të kontrollojë statusin e pikëve akredituese të zhvillimit të tij profesional.

3. Miratimi për punë të pavarur (licenca) dhe lejet për punë

Procedurat për dhënien, rinovimin dhe revokimin e licencave për stomatologë shtetas të Republikës së Kosovës janë të përcaktuara nga Oda, me rregulloren për regjistrim, licencim dhe rilicencim të stomatologëve.

Procedurat për dhënien e lejeve për punë në sektorin privat, janë të përcaktuara nga MSH.

Për shtetasit e huaj procedura e regjistrimit të përkohshëm të stomatologëve, që dëshirojnë të kryejnë përkohësisht ose herë pas here veprimtarinë në Republikën e Kosovës bëhet në MSH (kompetencë e saj).

Me rastin e rilicencimit, stomatologët janë të obliguar të kryejnë trajnim/aftësim profesional gjatë periudhës pesëvjeçare të licencës dhe të arrijnë minimumin 20 pikë në çdo vit të aktivitetet të formimit profesional.

Pas pesë viteve të vlefshmërisë së licencës, anëtari i Odës është i detyruar të paraqesë kërkesë për rilicencim.

Praktika dhe provimi profesional i stomatologëve dhe licencimi i profesionistëve të huaj bëhet nga MSH.

Praktika e deritanishme është dëshmuar që duhet ndryshuar kjo, sepse stomatologët po ballafaqohen me pengesa të ndryshme, si lista e pritjes për fillimin e stazhit profesional, mbikëqyerja e mirëfillt profesionale, ndërsa stomatologët e luginës së Preshevës po ballafaqohen me mosmundësin e paisjes me faksimil unik dhe hapjen e veprimtarisë private.

3.1 Strategjia e zhvillimit

Për shkak të rritjes së numrit të anëtarëve të Odës, është e nevojshme të përshpejtohen procedurat për dhënien dhe rinovimin e licencës për punë. Modernizimi i procedurave për dhënien dhe rinovimin e licencave dhe lejeve të punës. Kjo është e mundur me zhvillimin teknologjik të shërbimit profesional të Odës- zhvillimit të sistemit informativ, në mënyrë që anëtarëve të saj t'i siguron qasje të shpejtë dhe efikase në dokumente. Kështu, të nisen menjëherë procedurat që të sigurojë anëtarëve të saj regjistrimin on-line.

Me këtë regjistrim do ta përshpejtohen procedurat administrative. Të gjitha dokumentet e mëparshme që një anëtar i Odës ishte i detyruar t'i dorëzonte për inspektim dhe t'i dorëzonte në zyrë, do të zëvendësohen me një klikim të vetëm nga një kompjuter/telefon nga anëtari i Odës.

Rregullimi i praktikës profesionale dhe stomatologëve të huaj si dhe dhënia e lejeve për punë në sektorin privat, të rregullohet sipas praktikave të vendeve të ndryshme të rajonit dhe më gjërë, e që është kompetencë e Odës. Prandaj, të krijohet baza ligjore që këto përgjegjësi që i ka Ministria e Shëndetësisë, të kalojnë në Odë.

4. Sektorii publik stomatologjik

Në sistemin publik, janë të punësuar **387** stomatolog. Prej tyre në QKMF **299** stomatolog; në QKSUK **77** stomatolog dhe në Klinkën e Kirurgjisë maksillofaciale **11** stomatolog.

Numri i stomatologeve ne sistemin publik është si më poshtë:

Institucioni	Nr. i stomatologëve
QKSUK	77
KIRURGJIA	
MAKSILLOFACIALE	11
QKMF-PRISHTINE	47
QKMF-GJAKOVE	44
QKMF –PRIZREN	32
QKMF-MITROVICE	16
QKMF-PEJE	28
QKMF-FERIZAJ	22
QKMF-GJILAN	17
QKMF-MITROVICE	15
QKMF-LIPJAN	10
QKMF-RAHOVEC	9
QKMF-SUHAREKE	8
QKMF-VUSHTRRI	8
QKMF-ISTOG	7
QKMF-PODUJEVE	7
QKMF-RAHOVEC	9
QKMF-DEÇAN	6
QKMF-OBILIQ	5
QKMF-DRAGASH	5
QKMF-,MALISHEVE	5
QKMF-FUSHE KOSOVE	4
QKMF-KAMENICE	3
QKMF-GLLOGOVC	3
QKMF-SKENDERAJ	3
QKMF-KLINE	2
QKMF-JUNIK	2

Institucioni	Nr. i stomatologëve
QKMF-KAÇANIK	1
QKMF-SHTIME	1
QKMF- MAMUSHE	1
QKMF-HANI I ELEZIT	0

Shtrirja joadekuade e rrjetit të shërbimit stomatologjik në vend.

Rrjeti i institucioneve shëndetësore dytësore – poliklinikave gjithashtu nuk është uniform, jofunksional nëpër rajonet e Kosovës.

Mbyllja e njësive stomatologjike nëpër shkolla dhe kushtet hapësinore, pajisjet e ordinancave, njohuritë dhe trajnimi i stomatologëve në përdorimin e materialeve dhe teknologjive të reja gjithashtu nuk janë uniforme në nivel vendi.

Organizimi i kujdesit stomatologjik në tri nivelet e saja nuk është në tërësi funksional, i përcjellur me vështësi në planifikim të numrit të punonjësve, dhënien e shërbimeve stomatologjike sipas nivelit të kujdesit shëndetësor, statusi i nivelit dytësor i pakjartë. Pozita e punonjësve në sektorin e stomatologjisë ka pasur një përkeqësim të vazhdueshëm të statusit dhe të dinjitetit të tyre, ku ju është mohuar e drejta për punësim për ushtrimin e profesionit apo në pozita udhëheqëse menagjeriale, përkeqësimi i edukimit specialistik (pa ndonjë strategji mbi nevojat e sitemit public për fushat specialistike) shërndarja jo e barbartë e stomatologëve në vendet rurale, mbyllja e ordinancave stomatologjike në shkolla.

Kushtet hapësinore, pajisjet e ordinancave, njohuritë dhe trajnimi i stomatologëve në përdorimin e materialeve dhe teknologjive të reja gjithashtu nuk janë uniforme në nivel vendi.

Mungon e një strategji e mirëfilltë afatmesme apo afatgjate për zhvillimin e stomatologjisë në sektorin publik.

4.1 Strategjia e zhvillimit

Përcaktimi i një plani të kujdesit stomatologjik në tre nivelet e saja, duke marrë parasysh: gjendjen e shëndetit oral, numrin, moshën dhe strukturën sociale të popullsisë, nevojat për shërbime të caktuara stomatologjike, shpërndarja

proporcionale e stomatologëve sipas standardeve dhe normave që i përcakton OBSH-ja dhe praktikat e vendeve të rajonit dhe më gjërë.

Përcaktimi i institucioneve të kujdesit dytësor stomatologjik dhe llojet e shërbimeve stomatologjike që do të ofroheshin aty.

Hapja e njësive stomatologjike nëpër shkolla fillore dhe prania e pedodontit.

Krijimi i strategjive afatmesme dhe afatgjate për sektorin publik.

5. Stomatologjia preventive

Fatkeqësisht në Republikën e Kosovës nuk ka program kombëtar preventiv në fushën e stomatologjisë.

Masat preventive të nënvleftësuara e jo efektive në nivelet e kujdesit stomatologjik.

5.1 Strategjia e zhvillimit

Hartimi i programit kombëtar preventiv nëpërmjet programit “Qasja multidisiplinare në përmirësimin e shëndetit oral” nga MSH, në bashkëpunim me Odën, QKSUK dhe Degën e Stomatologjisë.

Zhvillimi i programeve të reja preventive që synojnë veçanërisht moshën fëmijërore.

6. Qendra Klinike Stomatologjike Universitare e Kosovës (QKSUK)

Qendra Klinike Stomatologjike Universitare e Kosovës është themeluar me 04.11.2003 si subjekt autonom, i ndarë nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës, ndërsa filloi punën si organizatë e pavarur më 1 janar 2004. Në vitin 2014 me ligjin për shëndetësi u krijua SHSKUK, ka qenë një hap kontrovers i reformës shëndetësore të proklamuar në atë kohë. Edhe pse ky model nuk ishte i testuar botërisht dhe se kishte një përvojë të limituar në një nga rajonet administrative të Suedisë. Thjeshtë u krijua një organizatë që menaxhon gjithë sektorin spitalorë të vendit dhe QKSUK e humbi autonominë e vet pas 10 viteve dhe u bë pjesë e SHSKUK, dhe që vazhdon edhe sot të jete pjesë e saj. Kjo e komplikoi skajshmërisht menaxhimin e saj sepse QKSUK asgjë nuk ka të bëjë me SHSKUK në shumë aspekte. Sot, QKSUK vetë emri i ka mbetur.

6.1 Strategjia e zhvillimit

Kthimi i autonomisë së QKSUK-së, e ndarë nga SHSKUK.

7. Sektori privat stomatologjik

Sektori privat stomatologjik në vendin tonë është i avansuar sa i përket pajisjeve dhe ofrimit të shërbimeve stomatologjike. Ofrohen të gjitha shërbimet stomatologjike bashkëkohore, pa pasur nevojë që qytetarët tanë të kërkojnë shërbime jashtë vendit në mungesë të shërbimeve brenda vendit.

Por shtrohet pyetja, a ka probleme ky sektor sot? Sigurisht që ka dhe ato e pengojnë përparimin e mëtejshëm të tij.

Legjislacioni në fuqi është jo i plotë, me role ende të paqarta e masa ndëshkuese jo efektive.

Tregu është i pakontrolluar sa i përket çmimeve të shërbimeve stomatologjike.

Anëtarët e Odës ballafaqohen me vështërsi në praktikën private, me çmime shumë të ulta për shërbimet e njëjta që ofrohen nga stomatologët.

Në mungesë të sigruimeve shëndetësore, gjegjësisht të fondeve të sigruimit shëndetësor në vendin tonë ende nuk kemi Nomenklaturën e shërbimeve shëndetësore/stomatologjike unike dhe çmimoren e shërbimeve, gjegjësisht çmimi minimal të shërbimeve. Oda deri më tani ka pritur të ketë bashkëpunim me agjensionin për sigurime shëndetësore, I cili e ka këtë kompetencë, por deri më tani nuka patur ndonjë kërkesë prej tyre për bashkëpunim në këtë fushë.

7.1 Strategjia e zhvillimit

Legjislacioni i qartë që definon rolet e organeve kompetente në sektorin privat stomatologjik.

Të ndryshohet baza ligjore që përcakton hapësirën, kuadrin profesional dhe pajisjet medicinale të institucioneve private shëndetësore

Përpilimi i Nomenklaturës unike për shërbimet stomatologjike.

Përcaktimi i çmimeve minimale për shërbimet stomatologjike.

8. Mbikëqyrja etike dhe profesionale

Me hyrjen në fuqi të Rregullores për përcaktimin e llojit të shkeljes etike dhe procedurat mbikëqyerjes etike dhe profesionale në dhjetor 2019, u ndryshua qasja për zgjidhjen e ankesave të pacientëve për punën e anëtarëve të Odës. Qëllimi i rregullores është të lehtësojë qasjen në pajtim si një procedurë e përshtatshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, të sigurojë disponueshmërinë, dhe të rrisë ndërgjegjësimin për pajtimin si dhe të sigurojë një marrëdhënie të balancuar midis pajtimit dhe procedurave gjyqësore.

Mbikëqyrja profesionale mbi punën e anëtarëve të Odës edhe pse me Ligjin e Profesionistëve Shëndetësor është kompetencë e Odës, ajo megjithatë drejtpërdrejtë nuk po ushtrohet sepse me këtë po mirret inspektoriati shëndetësor I MSH-së dhe deri më sot nuk ekziston bashkëpunimi apo koordinimi. Si rrjedhojë e kësaj, stomatologët, kryesihet të sektorit privat po ju nënshtrohen gjobave dhe është krijuar një konfuzitet nga institucionet mbikëqyerëse dhe vet profesionistëve nga aspekti i ofrimit të shërbimeve stomatologjike specifike, nga implantologjia dhe ortodoncia.

8.1 Strategjia e zhvillimit

Zbatimi i kompetencës së plotë ligjore të pavarur të mbikëqyerjes profesionale nga ana e Odës.

Bashkëpunimi i ngushtë me Inspektoriatin Shëndetësor dhe autoritet ekzekutive ose gjyqësore.

Praktikat aktuale të zgjidhjes paqësore të mosmarrëveshjeve ndërmjet anëtarëve të Odës dhe pacientëve të vazhdoen dhe të inkurajohen.

Zbatimi më i shpeshtë dhe më i gjerë i mbikëqyrjes profesionale mbi punën e anëtarëve të Odës me qëllim të ofrimit më i mirë të shërbimeve stomatologjike dhe me qëllim të ndërgjegjësimit të profesionistëve shëndetësorë për nevojën e respektimit të dispozitave ligjore dhe monitorimin e të gjitha çështjeve aktuale të profesionit.

9. Bashkëpunimi ndërkombëtar

Oda është anëtare e Federatës Botërore të Stomatologjisë (FDI) e themeluar në Paris më 15 gusht 1900. Federata është një organizatë botërore e stomatologëve që mbulon pesë rajone: Afrikë - ARO, Azi - APRO, Evropë - ERO, Amerika Latine - LARO dhe Amerika e Veriut - NARO.

ERO (Organizata Evropiane Rajonale e FDI) është organizatë evropiane e stomatologëve dhe Oda është poashtu anëtare e kësaj organizate.

Oda ka vendosur bashkëpunimin rajonal me Odat përkatëse, nga Kroacia, Maqedonia Veriore, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina si dhe institucioneve tjera. Problemet me të cilat përballen stomatologët në këtë fushë janë pothuajse identike, ka interesa të përbashkëta, mundësi dhe nevoja të përbashkëta.

9.1 Strategjia e zhvillimit

Të vazhdohet me pjesëmarrjen aktive në punën e organizatave botërore dhe evropiane, me FDI dhe ERO.

Monitorimi legjisllacionit dhe rregullat profesionale brenda BE-së duke marrë pjesë në konferenca ndërkombëtare dhe fillimi i harmonizimit të rregulloreve të Odës me to.

Forcimi dhe zgjerimi i bashkëpunimit me organizatat rajonale kombëtare stomatologjike më gjërë në drejtim të zhvillimit profesional të stomatologëve dhe çështje të tjera me interes për anëtarësinë e Odës.

10. Revista e Stomatologëve të Kosovës

Revista e Stomatologëve të Kosovës (RSK) është revistë zyrtare e Odës së Stomatologëve të Kosovës, e themeluar me 30 tetor 2021 nga Kuvendi i OSK-së.

RSK synon të informojë lexuesit për idetë, opinionet, zhvillimet dhe çështjet kryesore në stomatologji- që lidhen me kërkimet shkencore dhe praktikrat klinike, për të ngjallur interes, debat dhe diskutim.

Revista e Stomatologëve do të publikohet 2 herë në vit.

10.1 Strategjia e zhvillimit

Sigurimi i 2 (dy) botimeve në vit të Revistës së Stomatologëve të Kosovës.

Inkuraimi i vazhdueshëm i anëtarëve të Odës që të dërgojnë dorëshkrime për botim në revistë.

Synimi është që revista të indeksohet në të ardhmen e afërt në bazën e të dhënave Google Scholar.

KONKLUZIONI

Krijimi i Ligjit të veçantë për shërbimin shëndetësor stomatologjik në Republikën e Kosovës. Bazuar në praktikat dhe përvojat e shumë vendeve rajonale dhe më gjërë.

Ky ligj do të përcaktonte rregullat për organizimin dhe funksionimin e shërbimit shëndetësor stomatologjik në Republikën e Kosovësë.

- Institucionet që ofrojnë shërbim shëndetësor stomatologjik:: a) institucionet shëndetësore stomatologjike publike; b) institucionet shëndetësore stomatologjike privat;
- Financimi i shërbimit shëndetësor stomatologjik public;
- Shërbimi shëndetësor stomatologjik në QKMF;
- Shërbimi shëndetësor stomatologjik në institucionet (shkolla) e arsimit fillor: Shërbimi profilaktik, diagnostikues dhe edukimi shëndetësor stomatologjik.
- Shërbimi shëndetësor stomatologjik në QKSUK dhe në Klinikën e Kirurgjisë maksillofaciale
- Personeli i shërbimit shëndetësor stomatologjik (stomatologu, infermieri/e stomatologjik/e dhe laboranti dentar)
- Roli i Odës së Stomatologëve të Kosovës (Licencimi i profesionistëve shëndetësor; Edukimi i vazhdueshëm professional; Edukimi specialistik)
- Mbikëqyrja e shërbimit shëndetësor stomatologjik nëpërmjet Inspektoriatit stomatologjik

Në zbatim të reformës, ndryshimeve, propozohet përdorimi i modelit "2 + 2 + 2", i cili gradualisht, në një periudhë gjashtëvjeçare, brenda dy viteve, masat e propozuara do të çonin në një gjendje të kënaqshme të shëndetit oral të qytetarëve tanë.